



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PEQIN

Nr. ___ Prot.

Peqin, më ___ / ___ 2023

PROJEKT-VENDIM

Nr. ___ datë ___ / ___ /2023

Mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 24, pika 2, ligjin nr .22/2018 datë 03.05.2018 “Për Strehimin Social”, VKM nr.574, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërës prej programeve sociale të strehimit, afateve dhe procedurave të miratimit për organet e qeverisjes vendore”.

Propozim:

“Miratimin e Programit 5-vjecar i strehimit të Bashkisë Peqin”.

Në zbatim të nenit 68 të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për Strehimin Social” hartojmë “Programin 5-vjecar të Strehimit” për popullsinë nën juridiksion të Bashkisë Peqin, duke u mbështetur në analizën e nevojave për strehim dhe në përputhje me strategjinë e strehimit sipas parashikimeve të ligjit të sipërcituar.

Fakte mbi Bashkinë

Qarku:

Elbasan

Qendër bashkie:

Qyteti i Peqin

Sipërfaqja:

179.79 km katrorë

Popullsia:

38 900 banorë

Kryetar bashkie:

Bukurosh Maçi



Numri i anëtarëve të këshillit bashkiak:

21

Njësitë administrative:

Peqin, Pajovë, Karinë, Përparim, Gjocaj, Shezë

Faqja zyrtare e internetit:

www.peqini.gov.al

Peqini kufizohet në veri me bashkinë Tiranë, në lindje me bashkinë Elbasan, në jug-lindje me bashkinë Cërrik, në jug-perëndim me bashkinë Lushnje dhe në jug me bashkinë Belsh. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Peqinit. Sipas Censurit të vitit 2011, Peqini ka një popullsi prej 26.136 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 38.900 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 197.79 km katrorë me një densitet prej 196.67 banorë/km katrorë. Kjo bashki përbëhet nga 6 njësi administrative. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 50 fshatra e cila shtrihet përgjatë rrugës së vjetër Egnatia, ndërsa kalaja Klaudiana në qendër të qytetit është dëshmi e lashtësisë së këtij vendbanimi. Qyteti dhe të 50 fshatrat e kësaj bashkie shtrihen në një zonë fushore dhe kodrinore. Banorët e bashkisë së Peqinit janë të orientuar ndaj bujqësisë dhe vreshtarisë, por edhe mbarështimit të shpendëve. Kultivimi i ullinjve, i perimeve të serave dhe i produkteve të tjera bujqësore janë gjithashtu karakteristikë e zonës.

Vleresim i grupeve ne nevoje

Sipas të dhënave të administruara si rezultat i aplikimeve të bëra nga subjektet e interesuara rezulton se ka një nevojë të theksuar për të trajtuar persona që kanë aplikuar me programe strehimi. Konstatohet se aplikantët i përkasin shtresave të ndryshme të popullsisë duke përfshirë dhe pjestarë të komunitetit rom ,egjiptian. Një përqindje e caktuar të personave të interesuar banojnë në banesa të cilat janë në rrezik shembjeje dhe pothuajse të pabanueshme.

Ndërsa i konsiderueshëm është numri i familjeve të reja që kanë aplikuar për të përfituar skemat subvencionuese të programeve sociale të strehimit. Nga ana e sektorit të planifikimit të Bashkisë Peqin janë evidentuar troje në pronësi bashkiake të cilat do të shërbejnë për ndërtimin e objekteve të banimit që do të shërbejë për fondin e banesave sociale. Rëndësi të vecantë do ti jepet partneritetit publik dhe privat për të ndërtuar banesa sociale si dhe për të vënë në dispozicion me qira të të interesuarve objekte ekzistuese të rehabilituara dhe të gatshme për banim.



Më poshtë po paraqesim në mënyrë më të detajuar përmabjtjen dhe drejtimet kryesore të këtij programi të strehimit social.

1. Burimet e financimit.

Fonde për financimin e programeve sociale të strehimit do të sigurohen nga buxheti i Bashkisë Peqin, buxheti i shtetit si dhe fonde të siguruar me anë të donatorëve vendas apo të huaj. Prioriteti i Bashkisë Peqin është planifikimi dhe rritja cdo vit e fondit social si dhe përdorimit në raste të caktuara të fondit rezervë në përballimin e emergjencave që mund të lindin në sektorin e strehimit.

2. Kategorizimi i familjeve.

Bazuar në nenin 13, të ligjit nr.22/2018, datë 03.05..2018 "Për Strehimin Social" struktura përgjegjëse për strehimin social mbledh dokumentacionin, verifikon ligjshmerinë , si dhe klasifikon grupet e familjeve apo subjekteve që kanë aplikuar për të përfituar nga programet e Strehimit Social.

Vendimi i strukturës përgjegjëse i bëhet publik të interesuarve në faqen web të Bashkisë Peqin dhe në vendin e caktuar për afishimin e njoftimeve. Personat e interesuar do të njoftohen me anë të shërbimit zyrtar për të gjitha aktet administrative të Bashkisë Peqin nga të cilat heqin interes.

3. Fondi publik banesave sociale.

Evidentimi i fondit të banesave do të bëhet me përcaktimin e banesave që do të jepen me qera uzufukti dhe huapërdorje. Njëkohësisht do të përcaktohet numri dhe kategoritë e familjeve që do të përfitojnë banesa sociale me qira, uzurfukt ose huapërdorje. Aktualisht janë evidentuar si objekte shtesë pjesë përbërëse të fondit social të banesave, disa objekte të ndermarrjes se ish-ekstraksionit. Nisur nga levizjet e popullsisë drejt zonave urbane dhe emigracionit ne vendet e bashkimit europian ka rezultuar se numri i femijeve dhe nxenseve qe frekuentojne ko.pshtet dhe



cerdhet e Bashkise Peqine shte reduktuar ,fakti i cili eshte pasuar ne mbylljen e konsiderueshme te disa kopshteve dhe shkollave .Objektet ne te cilat zhvillohej mesim aktualisht jane te paperdorshme dhe parashikohet qe keto objekte me vendim te keshillit bashkiak te Bashkise Peqin te kalojne ne fondin public te banesave sociale.Këto objekte ndodhen në inventarin e pronave të Bashkisë Peqin.Pjese e fondit te banesave socilaie te cilat mund te jepen me qira jane dhe ato te cilat jane objekte ne pronesi private por me pelqimin e pronarit vendosen ne disopozicion te fondit per tu dhene em qira sociale.

Fondi public I banesave sociale do te perbehet nga Bashkia Peqin me ndertime te reja ,blerje te banesave ne treg te lire,pershtatje te objekteve te dala jashte funksionit,kalimi i pronesise mbi pronat e konfiksuar si dhe nga subjekte private ne 3% te siperfaqes ndertimore.

4. Banesa sociale me kosto të ulët.

Në vijm të zbatimit të programit të strehimit për banesa sociale me kosto të ulët do të evidentohen dhe kualifikohen numri i familjeve që do të përfitojnë banesa sociale me kosto të ulët. Prioriteti do ti jepet partneriteti me subjektet private. Banesat sociale me kosto te ulet do të ndërtohen me financime të Entit Kombëtar të Banesave në partneritet me bankat e nivelit të dytë si dhe interesant është fakti se për herë të parë do të shikohet mundësia e aplikimit të partneritetit publik –privat ku Bashkia Peqin do të vendosë në dispozicion të privatit troje të lira dhe do të përfitojë sipërfaqe banimi me përputhje me vlerën e truallit të vënë në dispozicion të indeksuar.

5. Masat subvencionuese.

Me fondet e siguruar nga buxheti i shtetit dhe buxheti i Bashkisë Peqin do të aplikohen masa subvencionese për shlyerjen e qirave ose të interesave të kredive me kushte lehtësuese per familjet qe perfitojne nga ky lloj programi te strehimit social . Nga këto masa do të përfitojnë edhe persona që kanë përfituar nga këto programe të strehimit social përpara miratimit të këtij plani veprimi. Aktualisht po trajtohen me masa subvencionuese familjet qe kane perfituar nga programi i banesave me kosto te ulet dhe aktualisht kanë vështirësi në shlyerjen e qirave apo interesave të kredive dhe që banojnë në pallatin e ndërtuar nga Enti Kombetar Banesave tek ish fusha e



portokallave. Prioritet nga programi i subvencionimit të qirase sociale do të kene jetimet, te moshuarit, PAK, invalidet, familjet e policeve te rene ne detyre si dhe emigrantet e ktyer nga emigraci

oni.

6. Evidentimi i trojeve.

Evidentimi i trojeve të pajisura me plan zhvillimi, infrastrukture për ndërtim banesash, numrin dhe llojin e banesave që do të përdoren, familjet që do të përfitojnë, formën e bashkëpunimit me sektorin privat si dhe masën e përqindjen e kontributeve do të jene qellimi i ketij programi. Trualli i lirë i përcaktuar për ndërtim banesash sociale ndoshtet te ish ndermarrja e ekstraksionit në një sipërfaqe të konsiderueshme prej 5000m².

7. Banesa objekt rehabilitimi.

Evidentimi i banesave ekzistuese në gjendje të rrënuar në pronësi publike apo private të cilat do të jenë objekt i trajtimit të investimeve për përmirësimin e kushteve të banimit. Këto objekte përbëhen nga ish-shkolla e vjetër si dhe godinat e ish-ekstraksionit.

8. Familje në rrisht.

Ne programin 5-vjecar te strehimit social prioritet jane dhe evidentimi i familjeve që jetojnë në banesa që mund të legalizohen dhe preken nga investime publike ose private, sipas planeve rregulluese. Kjo situatë do të trajtohet rast pas rasti në varësi të situatave që do të krijohen dhe është menduar që do të trajtohet me fondin rezervë.

9. Banesa e perkohshme



Prioritet imediat i Bashkise Peqin eshte disponimi i nje objekti te pershtateshem qe do te sherbeje per banese te destinua per strehim te perkohshme ,ne kushtet emergjences se strehimit te individeve te pastrehe ose qe kane nevoje per strehim te menjehershem dhe me afat te shkurter deri sa tu zgjidhet mundesia per strehim te qendrushem.

10.Banese e specializuar

Sigurimi i nje objekti i cili do te sherbeje per me infrastrukture te pershtatur dhe te aksesueshme per te plotesuar nevojat funksionale te shtresave ne nevoje te cilat mund te jene objekt i dhunes ne familje .

Konceptoi

Drejtori I Kujdesit dhe Mireqenies Sociale

Ardit Çanaku

KRYETARI I BASHKISE

Bukurosh MAÇI